

PROTOKOLL

Mbledhja e tretë e kryesisë së shoqatës e thirrur nga kryetari Ismet Abdyli

Data: 03.06.2018

Ora: 11:30

Vendi: Glattbrugg

Pjesmarrës: Ismet Abdyli, Muhamet Guda, Avni Kastrati, Qenan Haziri , Imran Asllani, Musa Halili

Mungon: Fadil Kqiku

Musafir: Muhamet Arifi

Temat e ditës:

1. Kërkesa për ndërtimin e shtëpis për Selver Arifit.

Muhamet Arifi sqaron punën e shtëpisë dhe beson se shtëpinë do ta ndërtojë me forcat vetanake (familjaret, si dhe te aferm të tij). Muhameti është i mendimit se angazhimi i shoqatës dhe hapja e aksionit në këtë është rast i panevojshëm. Kryesia e mbështet mendimin e Muhametit dhe njofton Selver Arifin për këtë vendim.

2. Ndihmë familje në nevojë

Kryesia e shoqatës 17shkurti.ch vendos ndarjen e 500 CHF për 10 familje në nevojë. Abdylmexhid Syqlevci dhe Arlind Abdyli e bëjnë pëzgjedhjen e familjeve në nevojë.

3. Renovimi i shportave të parku

Pas hudhjes së mjeteve pirroteknike në shporta, disa prej tyre janë dëmtuar në masë të madhe. Kryesia është e mendimit se duhet gjetura disa oferta dhe të bëhet rregullimi i tyre.

4. Punëtori i shoqatës

Pas dorheqjes së punëtorit pae paralajmruar shoqatën, kryesia e shoqatës ka hapur Konkursin për punëtorin e ri. Agron Murseli ka punuar deri me datën 06.05.2018 dhe për këto ditë do të bëhet pagesa 150 CHF (përfshihet koha e pushimit për 4 muaj e punuar). Shoqata e faleminderton Agron Murselin për punën e deritanishme. Paisjet e shoqatës duhet ti pranoj Arlind Abdyli dhe Afrim Kastrati.. Konkursi i punëtorit do të jetë hapur deri më 11.06.2018.

5. Sponzori gjeneral

Vita Solutions GmbH vazhdon të jetë sponzor gjeneral edhe për vitin 2018. Për këtë vitë firma HSM ka vendosur poashtu të jetë sponzor gjeneral. Faleminderim të veçant për kontributin e këtyre firmave.

6. Turniri tradicional

Shoqata vendos ndarjen e 150 Eurove për mbështetjen e turnirit 2018. Organizator i turnirit do të jenë personat e njëjtit sikur vitin e kaluar.